



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta –
Ministry of Culture, Youth and Sport*

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MKRS) NR. 08/2024 PËR
VULLNETARIZMIN RINOR ¹**

¹ Udhëzim Administrativ (MKRS) Nr. 08/2024 për Vullnetarizmin Rinor, miratuar nga Ministri me Vendimin Nr. 139/2024, të datës 31.12.2024

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

Në mbështetje të nenit 20, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 08/L-264 për Rininë (Gazeta Zyrtare Nr. 16/2024, 12.08.2024), nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 34/2022, 18.11.2022),

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MKRS) NR. 08/2024 PËR VULLNETARIZMIN RINOR

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim rregullimin e të drejtave, detyrimeve dhe procedurave lidhur me vullnetarizmin rinor.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. Shprehjet dhe termat e përdorur në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë si në Ligjin Nr. 08/L-264 për Rininë.

2. Shprehjet dhe termat e tjerë të përdorur kanë këtë kuptim:

2.1. **Ofrues i vullnetarizmit** do të thotë çdo person fizik apo juridik, organizatë joqeveritare, institucione publike dhe entitetet e sektorit privat të cilët angazhojnë vullnetarë të rinj për të kryer aktivitete jofitimprurëse për të mirën e komunitetit dhe të shoqërisë në përgjithësi;

2.2. **Mbështetës i vullnetarizmit** do të thotë çdo person fizik apo juridik të cilët mbështesin vullnetarët dhe/apo ofruesit e vullnetarizmit rinor si bizneset private, institucionet publike qendrore dhe lokale, figurat publike, mediat dhe pjesëtarët e diasporës;

2.3. **Platforma për Vullnetarizmin Rinor** do të thotë sistemi elektronik i Agjencisë për menaxhimin, promovimin dhe njohjen e punës vullnetare;

2.4. **Certifikata e Vullnetarizmit Rinor** do të thotë dokument publik që jepet në formë elektronike nga platforma për vullnetarizmin rinor për orët vullnetare të regjistruara nga vullnetari dhe të pranuar nga ofruesi i vullnetarizmit.

KAPITULLI II

VULLNETARIZMI RINOR

Neni 3

Vullnetari/e Rinor/e

1. Vullnetari/e rinor/e është personi fizik i/e moshës rinore që ofron shërbime pa pagesë në të mirën e shoqërisë.
2. Vullnetarët rinor të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës kanë të drejtë të jenë vullnetarë në territorin e Republikës së Kosovës, me kusht që të jenë të pajisur me leje qëndrimi të përkohshme ose të përhershme, të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt.
3. Shtetasi i Republikës së Kosovës mund të jetë vullnetarë rinor jashtë territorit të Republikës së Kosovës, në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe rregullat e përcaktuara në legjislacionin e vendit ku do të kryhet puna vullnetare.
4. Vullnetarizmi i certifikuar i kryer në Kosovë apo vend të huaj mund të shërbejë për qëllime të punësimit apo pranimit në institucione arsimore në Republikën e Kosovës.
5. Personat e mitur të grupmoshës 15-18 vjeç kanë të drejtë të kryejnë punë vullnetare nëse e kanë pëlqimin me shkrim të prindit apo kujdestarit ligjor.
6. Aktivitetet vullnetare nga personat e mitur duhet të jenë të përshtatshme për moshën e tyre, duke kontribuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive dhe duke siguruar që nuk dëmtojnë arsimimin, sigurinë, shëndetin dhe integritetin e tyre.

Neni 4

Parimet e Vullnetarizmit Rinor

1. Vullnetarizmi rinor bazohet në parimet e mëposhtme. Çdo ofrues i vullnetarizmit dhe vullnetarë/e është i/e obliguar t'i respektojë këto parime:
 - 1.1. Parimi i solidaritetit dhe promovimit të vullnetarizmit: vullnetarizmi duhet të promovohet si aktivitet me interes për Republikën e Kosovës dhe për interesin publik. Vullnetarizmi duhet të ketë për qëllim promovimin e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në shoqëri dhe zhvillimit të kompetencave të vullnetarit/es;
 - 1.2. Parimi i ndalimit të diskriminimit: ndalohet çdo lloj i diskriminimit dhe trajtim i pabarabartë nga ofruesit e vullnetarizmit ndaj vullnetarëve;
 - 1.3. Parimi i mbrojtjes së vullnetarëve: çdo ofrues i vullnetarizmit është i obliguar të mbrojë sigurinë dhe integritetin personal dhe interesat e vullnetarëve. Çdo vullnetarë duhet të mbrohet nga rreziqet në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.4. Parimi i ndalimit të përdorimit të vullnetarizmit për qëllime fitimprurëse: ndalohet që vullnetarizmi rinor të shfrytëzohet për qëllime përfituese apo fitimprurëse nga ofruesit e vullnetarizmit;

1.5. Parimi i kompensimit të vullnetarëve: vullnetarët nuk mund të kompensohen me të holla ose përfitime të tjera materiale për punën vullnetare. Mirëpo, ofruesit e vullnetarizmit rinor mund të mbulojnë shpenzimet gjatë kohës së angazhimit. Kompensimi mund të bëhet por nuk kufizohet në forma të listuara më poshtë:

1.5.1. Shpenzimet ditore, duke përfshirë transportin brenda dhe jashtë vendit dhe ushqimin;

1.5.2. Shpenzimet e transportit, fjetjes, ushqimit, sigurimit shëndetësor dhe/apo para xhepi në raste kur angazhimi vullnetar kërkon pjesëmarrje brenda dhe jashtë vendit;

1.5.3. Shpenzimet për pajisjet që nevojiten për ushtrimin e detyrës;

1.5.4. Shpenzimet shëndetësore në institucione publike në raste të aksidentit apo dëmit gjatë ushtrimit të punës vullnetare;

1.5.5. Shpenzimet e trajnimeve me pagesë për zhvillimin e kapaciteteve të vullnetarëve rinor;

1.5.6. Masa stimuluese duke përfshirë shpërblime dhe dhurata, lirim në pagesë në shërbimet publike si transporti urban, qasje në aktivitete sportive dhe kulturore dhe në shërbimet e ofruesve të vullnetarizmit si programet, ngjarjet, trajnimet dhe aktivitetet e tjera të tyre.

Neni 5 **Roli i Agjencisë**

1. Agjencia është përgjegjëse për mbështetjen dhe fuqizimin e vullnetarizmit rinor.
2. Agjencia administron dhe mirëmban platformën e vullnetarizmit rinor.
3. Agjencia organizon takime periodike me dhe fushata vetëdijësuese për ofruesit e vullnetarizmit mbi detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ndaj vullnetarëve.
4. Agjencia organizon takime periodike me dhe fushata vetëdijësuese për të rinjtë mbi detyrat dhe përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre si vullnetarë.
5. Agjencia themelon komision për shqyrtimin e ankesave ndaj ofruesve të vullnetarizmit rinor dhe përzgjedhjen e vullnetarëve të vitit.
6. Agjencia ofron dhe promovon ofrimin e stimuljve për vullnetarët rinor.

7. Agjencia ofron ngritje të kapaciteteve dhe mbështetje financiare për ofruesit e vullnetarizmit rinor, në veçanti për ata të cilët përmes masave afirmative angazhojnë vullnetarë rinor të marginalizuar.

Neni 6

Roli i Institucioneve Arsimore

1. Institucionet arsimore, në përputhje me misionin e tyre për edukimin dhe zhvillimin e përgjegjshëm qytetar të nxënësve dhe studentëve, duhet të angazhohen për të promovuar dhe mbështetur vullnetarizmin rinor.

2. Institucionet arsimore duhet të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e nxënësve dhe studentëve në aktivitete vullnetarizmi dhe t'i inkurajojnë ata të angazhohen në projekte që kontribuojnë në përmirësimin e komunitetit.

3. Institucionet arsimore kanë përgjegjësi për organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të vullnetarizmit rinor, duke përfshirë:

3.1. Formimin e grupeve apo klubeve vullnetare dhe ofrimin e mundësive për angazhim në projekte dhe aktivitete të vullnetarizmit;

3.2. Njohjen e pjesëmarrjes në këshillin e nxënësve dhe aktivitete të ngjajshme si vullnerizëm rinor;

3.3. Organizimin e trajnimeve për zhvillimin e aftësive dhe përgatitjen për angazhim në aktivitete vullnetarizmi;

3.4. Integrimin e aktiviteteve të vullnetarizmit në kurrikulen dhe aktivitetet edukative për të zhvilluar aftësi të rëndësishme dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e angazhimit në shërbim të komunitetit;

3.5. Monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të vullnetarizmit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e cilësisë dhe për të garantuar që ato kontribuojnë në zhvillimin e përgjegjshëm qytetar të nxënësve.

4. Institucionet arsimore duhet të krijojnë partneritete dhe të koordinojnë aktivitetet e vullnetarizmit me Agjencinë për të ofruar mundësi të shumta dhe për të rritur bashkëpunimin në aktivitetet e vullnetarizmit.

5. Vullnetarizmi mund të realizohet në kuader të arsimit formal, nëse qellimet e saja avancojnë kompetencat e parapara me kornizën kurrikulare të Republikës së Kosovës dhe organizohet nga shkolla. Këto kompetenca përfshijnë:

5.1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;

- 5.2. Kompetenca e të menduarit;
- 5.3. Kompetenca e të mësuarit;
- 5.4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis;
- 5.5. Kompetenca personale;
- 5.6. Kompetenca qytetare.

Neni 7

Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Ofrueseve të Vullnetarizmit Rinor

1. Ofruesit e vullnetarizmit kanë të drejtë të:

- 1.1. Kërkojnë që vullnetarët të paraqesin dokumente që vërtetojnë prapavijën e tyre arsimore ose profesionale, nëse është duke u lidhur një kontratë për kryerjen e një pune të tillë vullnetare që kërkon njohuri ose aftësi specifike;
- 1.2. Kërkojnë vullnetarët të paraqesin një vërtetim që nuk janë të ndjekur penalisht në rast se vullnetari/ja ka raste të mëparshme penale dhe mund të jetë pengesë për kryerjen e punës së synuar vullnetare.

2. Ofruesit e vullnetarizmit kanë për detyrë të:

- 2.1. Ofrojnë kushte të sigurta për angazhimin e vullnetarëve rinor, duke përfshirë parandalimin e dëmtimit fizik, mendor dhe emocional dhe informimin e vullnetarëve rinor mbi mekanizmat e ankesës brenda strukturave të ofruesit apo pranë Agjencisë;
- 2.2. Njoftojnë vullnetarët në formë të shkruar për procedurat dhe politikat e ofruesit të vullnetarizmit dhe të gjitha detyrat dhe obligimet të cilat ata duhet t'i kryejnë sipas marrëveshjes;
- 2.3. Sigurojnë mjetet e nevojshme të punës, ofrojnë siguri në punë dhe kushte të punës, dhe njoftojnë vullnetarët mbi rreziqet që mund të kanosen gjatë kryerjes së punës vullnetare;
- 2.4. Sigurojnë mjedise të punës të qasshme, të sigurta dhe të përshtatshme për të gjithë vullnetarët rinor pavarësisht gjinisë, aftësive, përkatësisë etnike, orientimit seksual, kushteve socio-ekonomike apo faktorëve të tjerë;
- 2.5. Ngrisin kapacitetet e vullnetarëve rinor kur është i domosdoshëm për të kryer punën vullnetare, kohë e cila do të njihet si orë vullnetare;
- 2.6. Ofrojnë mundësi vullnetarëve të marrin ditë të lira me arsyetim;

2.7. Verifikojnë dhe miratojnë në platformën e vullnetarizmit rinor orët e punës të kryera nga vullnetarët;

2.8. Lëshojnë vërtetim për vullnetarët, i cili do të përmbajë aktivitetet e kryera, orët e punës vullnetare, trajnimet e ndjekura nëse ka, dhe performancën gjatë punës vullnetare;

2.9. Ofrojnë mbulim të shpenzimeve ditore të vullnetarëve rinor dhe të rimbursojnë vullnetarët për çfarëdo shpenzimi të bërë gjatë përfshirjes së tyre në aktivitetet vullnetare;

2.10. Caktojnë mentorë të përshtatshëm për të punuar me të rinjtë të cilët do të mbështesin vullnetarët rinor gjatë kryerjes së punës vullnetare;

2.11. Sigurojnë që të rinjtë nën moshën 18 vjeçare angazohen si vullnetarë me pëlqimin e prindit apo kujdestarit ligjor, dhe nuk t'i angazhojnë ata në kohë e cila bie ndesh me orarin e tyre shkollor përveç nëse aktiviteti organizohet nga shkolla;

2.12. Sigurojnë që vullnetarizmi të mos zëvendësojë punën me pagesë dhe të mos privojë vullnetarët nga përfitimet sociale;

2.13. Sigurojnë që vullnetarizmi të mos keqpërdoret për rritjen e përfitimeve vetanake;

2.14. Mbajnë regjistër të vullnetarëve, të dhënat e të cilëve do të ruhen në pajtim me legjislacionin në fuqi mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Grupet joformale dhe personat fizik të cilët angazhojnë vullnetarë rinor mund të bashkëpunojnë me ofrues të vullnetarizmit rinor të regjistruar në platformën elektronike për vullnetarizëm për përmbushjen e detyrave të këtij Neni.

Neni 8

Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Vullnetarëve

1. Vullnetarët kanë të drejtë të:

1.1. Informohen mbi punën vullnetare që do të kryhet dhe detyrat e tyre të punës para fillimit të punës vullnetare;

1.2. Kërkojnë kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës dhe informata mbi mekanizmat e ankesës brenda strukturave të ofruesit apo pranë Agjencisë;

1.3. Trajnohen, nëse është e nevojshme, në përputhje me natyrën e punës që do të kryejnë;

1.4. Marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në lidhje me vullnetarizmin rinor;

1.5. Kërkojnë që puna e tyre vullnetare të regjistrohet në platformën e vullnetarizmit rinor dhe të pranojnë vërtetim nga ofruesi për punën e tyre vullnetare;

- 1.6. Përfitojnë nga ditë të lira me arsyetim;
 - 1.7. Kërkojnë mbrojtjen e të dhënave personale;
 - 1.8. Kërkojnë sigurimin e mjedisit të qasshëm të punës për vullnetarët me nevoja të veçanta;
 - 1.9. Refuzojnë të bëjnë punë vullnetare nëse puna nuk korrespondon me aftësitë e tyre, përfshin rrezik për sigurinë dhe shëndetin, dhe bie ndesh me parimet, vlerat dhe besimet e tyre;
 - 1.10. Njoftojnë me kohë dhe tërhiqen nga puna vullnetare pa pasoja apo kosto.
2. Vullnetarët kanë për detyrë të:
- 2.1. Ofrojnë shërbimet me mirëbesim;
 - 2.2. Respektojnë detyrimet që parashihen me marrëveshje;
 - 2.3. Respektojnë rregullat profesionale dhe etike të ofruesit të vullnetarizmit;
 - 2.4. Ruajnë informatat konfidenciale të ofruesit, gjatë dhe pas kryerjes së punës vullnetare;
 - 2.5. Regjistrohen në platformën e vullnetarizmit rinor;
 - 2.6. Ofrojnë shërbime vullnetare, pa ndërmjetësimin e të tjerëve;
 - 2.7. Në rast se është e nevojshme, të marrin pjesë në trajnime për të zhvilluar kapacitetet e tyre;
 - 2.8. Njoftojnë ofruesin për sëmundje apo ndonjë pengesë tjetër që do ta pengonte kryerjen e punës ose rrezikonte sigurinë dhe shëndetin e tyre apo të tjerëve;
 - 2.9. Kompensojnë dëmet e shkaktuara nga ata në raste të demit të qëllimshëm apo neglizhencës së rëndë;
 - 2.10. Sinjalizojnë ofruesin e vullnetarizmit dhe/apo Agjencinë kur dëshmojnë rrezikimin e sigorisë dhe shëndetit të tyre apo vullnetarëve të tjerë dhe shkeljen e parimeve sipas nenit 4 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 9

Marrëveshja e Vullnetarizmit

1. Vullnetarizmi rinor rregullohet me marrëveshje me shkrim, ndërmjet ofruesit të vullnetarizmit dhe vullnetarit/es (Shtojca 1).
2. Marrëveshja e vullnetarizmit përcakton të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të vullnetarizmit dhe vullnetarit/es dhe kushtet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare.

3. Marrëveshja duhet të përmbajë këto të dhëna por nuk kufizohet në:

- 3.1. Emrin e palëve kontraktuese;
- 3.2. Të dhënat personale;
- 3.3. Selinë e ofruesit të vullnetarizmit dhe vendbanimin e vullnetarit/es;
- 3.4. Përshkrimin e punës vullnetare që do të kryhet;
- 3.5. Të drejtat dhe detyrimet e palëve;
- 3.6. Specifikat e kompensimit të shpenzimeve që do të bëhet dhe në cila forma;
- 3.7. Orët e punës vullnetare dhe pushimin;
- 3.8. Kohëzgjatjen e marrëveshjes;
- 3.9. Emrin e mentorit/es dhe personit përgjegjës;
- 3.10. Datën dhe vendin e lidhjes së marrëveshjes.

4. Për personat e mitur të grupmoshës 15-18 vjeç, prindi apo kujdestari i tyre ligjor nënshkruan marrëveshjen.

5. Marrëveshja e vullnetarizmit duhet të bazohet në të drejtat, detyrimet dhe procedurat të specifikuara në këtë udhëzim administrativ.

6. Marrëveshja për vullnetarizmin shkëputet në këto raste:

- 6.1. Me skadimin e marrëveshjes;
- 6.2. Me marrëveshjen e dyanshme të palëve kontraktuese për shkëputje;
- 6.3. Me shkëputjen e njëanshme të marrëveshjes në raste të shkeljes së obligimeve kontraktuale dhe/apo parimeve të vullnetarizmit rinor;
- 6.4. Në raste kur prindi apo kujdestari ligjor i të miturit/es tërheqë pëlqimin;
- 6.5. Në raste të tjera specifike të parapara me marrëveshje.

Neni 10

Platforma e Vullnetarizmit Rinor

1. Platforma e vullnetarizmit rinor shërben për shkëmbimin e informatave dhe mundësive ndërmjet të rinjve që dëshirojnë të bëjnë vullnetarizëm dhe ofruesve të vullnetarizmit rinor, regjistrimin e orëve të punës vullnetare si dhe lëshimin e certifikatës së vullnetarizmit rinor.
2. Agjencia përmes stafit përgjegjës administron dhe mirëmban platformën e vullnetarizmit rinor, ku përfshihet baza e të dhënave dhe aplikacioni për ofruesit e vullnetarizmit dhe vullnetarët.
3. Të gjithë ofruesit e vullnetarizmit rinor të cilët shprehin gatishmëri do të kenë qasje në platformën e vullnetarizmit rinor.
4. Vullnetarët do të jenë në gjendje të regjistrojnë orët e tyre të punës vullnetare dhe të shkarkojnë certifikatat e tyre në formë elektronike.

Neni 11

Regjistrimi i Vullnetarëve

1. Ofruesi i vullnetarizmit rinor është i obliguar të regjistrojë të dhënat e vullnetarëve në regjistrat e organizatës përkatëse duke përfshirë kopje të marrëveshjes të nënshkruar dhe pëlqimin e prindit apo kujdestarit ligjor nëse aplikohet.
2. Ofruesi i vullnetarizmit është i obliguar të regjistrohet në platformën e vullnetarizmit rinor përmes aplikimit online si subjekt juridik.
3. Ofruesi i vullnetarizmit ofron mbështetje për vullnetarët gjatë regjistrimit në platformën e vullnetarizmit rinor, ku përfshihen të dhënat personale identifikuese si dhe orët vullnetare.
4. Ofruesi i vullnetarizmit është i obliguar të raportojë përmes platformës së vullnetarizmit rinor për çdo ndryshim në statusin dhe marrëveshjen me vullnetarin.
5. Me përfundimin e marrëveshjes për vullnetarizëm, ofruesi i vullnetarizmit rinor është i obliguar t'i miratojë orët e regjistruara në platformën e vullnetarizmit rinor.
6. Agjencia ka të drejtën të vlerësoj dhe kontrolloj këto të dhëna.

Neni 12

Certifikata e Vullnetarizmit Rinor

1. Agjencia ka për detyrë të mirëmbajë dhe zhvillojë platformën e vullnetarizmit rinor.

2. Platforma e vullnetarizmit rinor mundëson regjistrimin e orëve individuale vullnetare nga vullnetari/ja rinor/e, aprovimin e tyre nga ofruesi i vullnetarizmit rinor dhe lëshimin e certifikatave të vullnetarizimit në mënyrë digjitale dhe automatike.

3. Certifikata e vullnetarizmit mund të shërbejë në proceset e punësimit dhe edukimit.

4. Certifikata e vullnetarizmit mund të përfshijë të dhënat personale të vullnetarit/es, të dhënat e ofruesit të vullnetarizmit, orët e vullnetarizmit dhe një përshkrim të natyrës së punës apo aftësive të përfituara.

Neni 13

Përzgjedhja e Vullnetarëve të Vitit

1. Komisioni i Vullnetarizmit Rinor, përmes platformës së vullnetarizmit rinor dhe kritereve të përcaktuara nga Agjencia për vitin përkatës, shpallë vullnetarët e vitit, bazuar në kontributin e dhënë në dobi të shoqërisë përmes vullnetarizmit rinor.

2. Çmimet mund të përfshijnë, por nuk limitohen, në fushat:

2.1. Mobilizimi i vullnetarizmit rinor;

2.2. Dialogu ndërkulturor (në nivel vendi, rajoni dhe më gjerë);

2.3. Intervenimi në komunitet;

2.4. Promovimi i kulturës dhe sportit;

2.5. Mbrojtja e mjedisit.

3. Përfitues të çmimeve mund të jenë vullnetarët rinor, ofruesit e vullnetarizmit rinor dhe mbështetësit e vullnetarizmit rinor.

4. Vullnetarët e Vitit, për kontributin e dhënë, duhet të shpërblehen me mirënjohje dhe masa tjera stimuluese dhe shpërblyese.

5. Për obligimet që dalin nga paragrafi 4 i këtij neni obligohet Agjencia.

Neni 14

Ndalimi i Ofrimit të Vullnetarizmit

1. Me vendim të Agjencisë, një ofrues i vullnetarizmit mund të marr vërejtje apo të humbas të drejtën për një kohë të caktuar të angazhoj vullnetarë të rinj nëse bënë shkeljet e mëposhtme:

1.1. Nuk lidh marrëveshje me shkrim me vullnetarin/en;

- 1.2. Bënë shkelje të rëndë të marrëveshjes me vullnetarin/en;
 - 1.3. Nuk mban evidencë mbi punën vullnetare përfshirë këtu të dhëna për kohëzgjatjen, trajnimet, shkathtësitë e fituara gjatë punës vullnetare;
 - 1.4. Nuk i regjistron vullnetarët në platformën e vullnetarizmit rinor ose regjistron vullnetarët pa dëshmi përkatëse;
 - 1.5. Në rast që vërtetohet se ka abuzuar qëllimisht me vullnetarët apo ka shkelur rëndë parimet e vullnetarizmit rinor;
 - 1.6. Në rast që nuk ofron dëshmi bindëse që ka ndërmarrë veprime konkrete të parandalimit të abuzimit me vullnetarët.
2. Në raste të shkeljeve sipas nenin 1 të këtij Neni, masat që mund të ndërmerren nga Agjencia janë:
- 2.1. Nxjerrja e vendimit publik duke evidentuar shkeljet kundër ofruesit;
 - 2.2. Ndalimi i certifikimit të orëve vullnetare;
 - 2.3. Ndalimi i mbështetjes financiare nga fondet publike;
 - 2.4. Ndalimi nga marrja e çmimeve dhe/apo njohjeve nga Agjencia.
3. Kohëzgjatja e masave vendoset me vendim të Komisionit.
4. Ofruesi i vullnetarizmit mund të paraqes ankesë mbi vendimet e komisionit e cila duhet të trajtohet nga një komision i ankesave sipas afateve të procedurave të përgjithshme administrative.

Neni 15

Komisioni për Vullnetarizmin Rinor

1. Agjencia themelon komision të përkohshëm për shqyrtimin e pikave si më poshtë:
 - 1.1. Për shqyrtimin e ankesave lidhur me certifikimin e vullnetarëve;
 - 1.2. Për shqyrtimin e rasteve të sinjalizimit nga vullnetarët;
 - 1.3. Për përzgjedhjen e vullnetarëve të vitit.
2. Komisioni themelohet nga Drejtori/esha Ekzekutiv i Agjencisë dhe përbëhet nga tre (3) përfaqësues të Agjencisë, përveç nëse Drejtori/esha vlerëson të nevojshëm angazhimin e përfaqësuesve të Këshillit Qendror Rinor.

3. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit nga paragrafi 2 i këtij neni, Agjencia duhet të parasheh me vendim një (1) anëtarë rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e komisionit i cili ka konflikt interesi.

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE SHFUQIZUESE

Neni 16

Dispozitat Shfuqizuese

Shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2016 për Punën Vullnetare të të Rinjve dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 17

Hyrja në Fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Hajrulla ÇEKU

Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

31.12.2024

SHTOJCA 1: Shembull Marrëveshje për Vullnetarizëm Rinor

Ofruesi i Vullnetarizmit

- Emri i organizatës: _____
- Adresa e selisë: _____
- Emri i përfaqësuesi ligjor : _____

- Emri i mentorit të vullnetarit/es: _____
- Pozita: _____
- Numri i telefonit: _____
- Email: _____

Vullnetari/ja

- Emri dhe mbiemri: _____
- Data e lindjes: ____/____/____
- Numri personal: _____
- Adresa e vendbanimit: _____
- Numri i telefonit: _____
- Email: _____

Për personat e moshës 15-18 vjeç

- Emri i prindit/kujdestarit ligjor: _____
- Numri personal: _____
- Numri i telefonit të prindit/kujdestarit ligjor: _____
- Emaili i prindit/kujdestarit ligjor: _____

- ☐ Unë, si prind/kujdestar ligjor, jap pëlqimin tim që fëmija im të marrë pjesë në aktivitetet vullnetare të përshkruara në këtë marrëveshje.

1. PËRSHKRIMI I DETYRAVE

Detyrat që do të kryhen nga vullnetari/ja:

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

2. KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

- Data e fillimit: ____/____/____
- Data e përfundimit: ____/____/____
- Dita dhe ora e angazhimit²: _____
- Totali maksimal i orëve vullnetare³: _____

3. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE

- Specifikat e kompensimit:
 - ☐ Shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen.
 - ☐ Shpenzimet e ushqimit do të mbulohen.
 - ☐ Shpenzimet e ushqimit do të mbulohen kur angazhimi vullnetar kalon 4 orë/ditë .
 - ☐ Shpenzime të tjera: _____

² Për shembull, çdo të marte, nga ora 17.00-19.00. Nëse orari është i ndryshueshëm, shenoni 'sipas nevojës.'

³ Shenoni totalin maksimal të orëve brenda periudhës së marrëveshjes.

4. PËRGJEGJËSITË E OFRUESIT TË VULLNETARIZMIT

- ☐ Të informojë vullnetarin/en për detyrat dhe përgjegjësitë përpara angazhimit të tij/saj.
- ☐ Të caktoj mentorin/en për vullnetarin/en gjatë anagazhimit të tij/saj.
- ☐ Të respektojë orarin, dhe të sigurojë kushtet e nevojshme për kryerjen e punës.
- ☐ Të ofrojë ditë të lira për vullnetarin/en, në raste kur angazhimi është mbi 20 orë në javë, për më shumë se 3 muaj.
- ☐ Të ofrojë trajnim dhe mbështetje gjatë angazhimit.
- ☐ Të mbajë konfidencialitetin e të dhënave personale të vullnetarit/es.
- ☐ Të regjistrojë dhe verifikojë orët e punës së vullnetarit/es.
- ☐ Të lëshojë certifikatë për orët e punës së vullnetarit/es, nëse ai/ajo i kanë respektuar kushtet e kësaj marrëveshje.
- ☐ Të ndërpresë marrëveshjen në rast të shkeljes së detyrimeve nga vullnetari/ja.

5. PËRGJEGJËSITË E VULLNETARIT/ES

- ☐ Të respektojë kushtet e përcaktuara në marrëveshje.
- ☐ Të marrë pjesë në trajnimet e ofruara, nëse është e nevojshme.
- ☐ Të respektojë rregullat dhe politikat e organizatës, duke përfshirë standardin e mirësjelljes.
- ☐ Të ruajë konfidencialitetin e informacioneve gjatë dhe pas angazhimit.
- ☐ Të njoftojë organizatën me kohë, për çdo pengesë që mund të ndikojë në angazhimin vullnetar.
- ☐ Vullnetari/ja pajtohet që fotografitë/inçizimet që organizata mund t'i bëjë gjatë angazhimit vullnetar mund të përdoren nga organizata për qëllime informative/promovuese, pa kompensim.

6. SHKËPUTJA E MARRËVESHJES

Marrëveshja mund të shkëputet në rastet e mëposhtme:

- ☐ Me skadimin e periudhës së marrëveshjes.
- ☐ Me marrëveshje të dyanshme ndërmjet palëve.
- ☐ Me shkëputje të njëanshme në rast të shkeljes së detyrimeve.
- ☐ Kur prindi/kujdestari ligjor tërheq pëlqimin (për të miturit).

7. DATA DHE VENDI

- Vendi i nënshkrimit të marrëveshjes: _____

- Data: ____/____/____

Ofruesi i Vullnetarizmit	Vullnetari/ja	Prindi/Kujdestari Ligjor (Për personat 15-18 vjeç)
Emri dhe mbiemri:	Emri dhe mbiemri:	Emri dhe mbiemri:
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:	Nënshkrimi:

Shënim: Kjo marrëveshje është hartuar në dy kopje identike, nga një për secilën palë.